

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË

"E J J SECURITY" SH.P.K.

Ky statut do të konsiderohet se përfshin dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë, organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, më 03.03.2023, unë Etmira Taga, shtetase shqiptare, lindur më 05.05.1979, lindur dhe banuese në Laç, Kurbin, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. personal H95505063R, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratoj këtë Statut si vijon:

Në këtë Statut:

- "Ligji" është Ligji nr.9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar*
- "Statuti" është ky Statut i Shoqërisë*

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja

Neni I

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi, Selia

Sot, më 03.03.2023 unë, themeluesi i mësipërm, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin tregtar "E J J SECURITY" SHP.K



Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm: Sherbimi i rojeve civile, ruajtja e objekteve shtetërore, privat, e ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike, shqiptare ose te huaj, ruajtja e rendit ne keto objekte dhe sigurimi i jetes se personelit e te vlerave pasurore te tyre gjate levizjes edhe aktivitetet tjera qe do te konsiderohen te pershtatshme per zhvillimin e shoqerise. Sherbime, riparime, prerje dhe qepje te pjeseve dhe kepuceve te plota te te gjitha modeleve, me materiale porosites. Transporti i rregullt i udhetareve dhe mallrave brenda dhe jashte vendit.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.

Neni 4

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga kryesore Laç - Milot, ndertese 1 kateshe, ZK. 3441, me pasuri Nr. 124/4.

Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

*Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe zotërohet tërësisht nga ortakët themelues z, **Etmira Taga** zotërues i i (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 lek që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.*

Kontributi i ortakut është në para.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- *Kontributit në kapitalin e shoqërisë*
- *Shitblerjes*
- *Trashëgimisë*
- *Dhurimit*
- *Çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj.*

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nëpërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Kreu III

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Neni 8

Organi vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë*
- b. Ndryshimet e statutit*
- c. Emërimin e shkarkimin e administratorëve*
- d. Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar*
- e. Përcaktimin e shperblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d të kësaj pike.*
- f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.*

Eay

- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportve të ecures së veprimtarisë
- h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- m. Shpërndarjen e fitimeve vjetore
- n. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administrator i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njejtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statute, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është ethirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votive të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votive të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi I politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin e likuiduesve të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë ne gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; mitarimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë.

Neni 12

Ety

Përfashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jot e përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqsohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati I emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi I administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Komëtare të Biznesit.

Personat e mëposhtëm caktohen si administratorë të parë të shoqërisë për një mandate të plotë 5 (pesë) vjeçar emërimi:

- ***Z. Etmira Taga*** shtetase shqiptare, lindur më 05.05.1979, lindur dhe banues në Laç Kurbin, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal ***H95505063R*** madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, pa kufizime në kompetencat e administrimit.

Kreu IV

Viti financiar – ekspertët

Neni 14

Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor.

Përfashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor.

Neni 15

Ekspertët



Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtua e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu 5

Prishja – riorganizimi i shoqërisë

Neni 16

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të asamblesë së ortakëve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2017; me vendim të gjykatës. Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”. Prishja e shoqëris tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortakët. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, Brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

Neni 17

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja



Neni 17

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, sipas vendimit të mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën VIII të ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 18

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente gjykata shqiptare.

Ky akt u hartua në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:

ORTAKU THEMELUES

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"E J J SECURITY" SHP.K

Zj. Etmira Taga

